

THIRRJE PËR APLIKIM PËR KOMPETICIONIN E PUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR

Departamenti i Financës, FEUT njofton një mundësi unike për studentët e Vitit të Tretë të programit Bachelor në Financë, për të marrë pjesë në një konkurs të veçantë kërkimor-shkencor: Financat shqiptare nën optikën studentore – Një qasje proaktive duke nxjerrë në pah kreativitetin, aftësinë analitike dhe potencialin inovativ të studentëve.

Kriteret e Pjesëmarrjes:

- Pjesëmarrësit duhet të jenë studentë të vitit të tretë të programit Bachelor në Financë.
- Prezantimet do të realizohen në grupe prej të paktën dy studentësh, duke shtjelluar nënfusha të ndryshme dhe trendet e fundit në financë.
- Secili grup duhet të hartojë një punim kërkimor-shkencor me një qasje kritike dhe të thelluar ndaj temës së zgjedhur.

Detajet e Konkursit:

- Prezantimet duhet të jenë të strukturuar në mënyrë të qartë, të bazuara në metodologji të saktë kërkimore dhe të paraqitura pastër gramatikisht.
- Përgatitja e materialeve duhet të reflektojë punën intensive kërkimore dhe analizën e detajuar të të dhënave, duke mbështetur argumentet me referenca të besueshme akademike.

Faza Finale:

- Të gjithë grupet që do të kalojnë në fazat e para të konkursit do të ftohen në fazën finale, e cila do të mbahet më datën 28 prill në Godinën 'Liria'.
- Në këtë fazë, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të paraqesin punimet e tyre para një jurie të përbërë nga pedagogë dhe ekspertë të njohur në fushën e financës.
- Përveç përvojës praktike dhe vlerësimit akademik, kjo është një mundësi e shkëlqyer për të zgjeruar rrjetin profesional dhe për të marrë këshilla të vlefshme nga profesionistë të fushës.
- Grupi fitues i konkursit do të shpërblehet me një çmim, që do të ofrohet nga sponsorët e aktivitetit.

Ju inkurajojmë të shfrytëzoni këtë mundësi për të demonstruar aftësitë tuaja kërkimore dhe për të kontribuar në zhvillimin e mendimit kritik në fushën e financës. Ky konkurs është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit profesional dhe akademik, duke ju ofruar një platformë për të ndarë idetë dhe zbulimet tuaja me komunitetin akademik.

Për aplikim dhe më shumë detaje, ju lutemi kontaktoni Departamentin e Financës!

Email: departamentifinance@fakultetiekonomise.edu.al